



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS

Durrës 06.05.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

Në përgjigje të ankesës të znj.Luljeta Cani, sqarojmë si më poshtë :

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.57, datë 20.04.2021 “Për miratimin e ndihmës financiare me vlerë 4 995 416 (katërmilion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë e katërqind e gjashtëmbjdhjetë) lekë me TVSH, për familjet e dëmtuara si rezultat i dëmit të shkaktuar nga prishja e detyruar e objekteve/ndërtesave në Njësinë Administrative Nr.3, të dëmtuara nga tërmeti i datës 29 nëntor 2019, sipas listës bashkëngjitur”, familja Cani rezulton përfituese me vlerën përkatëse si rezultat i dëmit të shkaktuar nga prishja e detyruar të banesës së saj. Sqarojmë që kjo vlerë përlllogaritet në zbatim të procedurave të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.329, datë 16.05.2012, i ndryshuar “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, ku përkatësisht thuhet se :

Vlerësimi financiar i dëmeve për strukturat e banimit, objektet e biznesit, strukturat me karakter bujqësor e blegtoral etj. bëhet: - në rastet e shkatërrimit në total të tyre, sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin përkatës; - në rastet e tjera, me çmimet në fuqi, sipas zërave të punimeve të ndërtimit, miratuar nga Këshilli i Ministrave për Entin Kombëtar të Banesave për qytetin përkatës. Si rrjedhojë në kuadër të dispozitave të sipërcituara, grupi i punës ngritur me Urdhërin nr. 419, datë 29.12.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit për dëmet e shkaktuara në ndërtesat pronë private, nga prishja e detyruar me demolim (tritol)” i ndryshuar”, ka kryer procedurën e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga prishja e detyruar me demolim në banesën e e znj.Cani.

Gjithashtu, në kudoër të procesit të rindërtimit, është zhvilluar një korrespondencë me Ministrinë e Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, për mbulimin e këtij fondi nga ana e tyre, gjë e cila nuk është mundësuar, dhe me shkresën nr. 584/1 prot., datë 02.02.2022, protokolluar me tonën nr.455/2 prot., datë 03.02.2022 është kërkuar që ky fond të mbulohet nga ana e Bashkisë. Si rrjedhojë, nga ana e Bashkisë do të merren të gjitha masat që mundësia e mbulimit financiar të jetë në përputhje me parashikimin vjetor të emergjencave civile në nivel vendor.